



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT

Nr 637/prot.
1

Kamëz, më 31/7/2025

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “për Vetëqeverisjen Vendore”; në Ligjin nr.48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;

Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, institucion në varësi të Bashkisë Kamëz, shpall **3 (tre) vende vakante për pozicionin Sanitare pranë Kopshtit nr.21 “Univers” Laknas, Bashkia Kamëz.**

Dokumentacioni i kërkuar në dosjen personale, në momentin që aplikanti shpallet fitues:

1. CV
2. Vërtetim banimi
3. Dëftesë/ Diplomë + listë notash (kopje të noterizuara)
4. Çertifikatë personale dhe familjare
5. Librezë pune origjinale ose fotokopje e noterizuar
6. Raport mjeko – ligjor
7. Dëshmi penaliteti (deri në momentin e paisjes me dëshmi penaliteti, fotokopje të kuponit të aplikimit në postë)
8. 2 fotografi
9. Vërtetimin nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi

Disa nga detyrat që duhet të kryejë Sanitarja janë:

1. Ruan standartet e pastërtisë në mjediset e brendshme dhe të jashtme të çerdhes.
2. Zbaton detyrat dhe udhëzimet që i jep Drejtuesja dhe edukatorja.
3. Pastron dhomat e fëmijëve dhe gjithë ambientet e tjera, anekset dhe oborrin përreth çerdhes.
4. Kujdeset për larjen e materialeve të buta.

5. Kujdeset për ngrohjen e mjediseve të ndenjes së fëmijëve.
6. Kujdeset për pastrimin dhe gjelbërimin e mjediseve të jashtme të çerdhes.
7. Njeh dhe zbaton rregulloren e brendshme të institucionit.

Për pozicionin e punës si Sanitare në Kopësht, duhen plotësuar kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsimin e mesëm

Dorëzimi i dokumentacionit do të kryhet me postë për Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në Bashkinë Kamëz brenda datës **15.08.2025**

[Signature]

DREJTOR

Aferdita Zefi

[Signature]
Rovine Koz

[Signature]

